

Mr. Gjon BERISHA

KONTRIBUTI I ILIRËVE NË CIVILIZIMIN PERËNDIMOR- RASTI I SHËN JERONIMIT

Historia dhe jeta e ilirëve dhe e Ilirisë veçse nga autorët grekë e romakë u shkrua dhe u shqyrtua edhe nga autorë të tjerë, prejardhja e të cilëve shpesh nuk është ditur saktësisht. Kjo ndodhte meqë ata shkruanin në gjuhën greke apo latine, pastaj biografia e tyre shpesh herë është e varfër dhe pasi shumë herë ata identifikoheshin si grekë apo romakë. Në mesin e tyre kishte padyshim edhe të tillë që kishin prejardhje ilire, por që këtë fakt ata nuk e cekën. Ndoshta ndër të parët autorë ilirë të antikitetit të vonë që e bëri të njohur prejardhjen e tij iliro-arbërore, i cili konsiderohet shkrimtar i shquar, nismëtar i shkencës letrare të mesjetës është personaliteti që njihet përbotërisht me emrin Shën Jeronimi, i lindur në Stridon të Dalmacisë.

Ai që ndër të parët e përktheu Biblën nga origjinali hebraisht në latinisht, e që merret si vepra më autentike dhe si e tillë i kaloi shekujt.

Personaliteti i Shën Jeronimit është shumë kompleks dhe i gjithanshëm, prandaj edhe studimi i jetës dhe veprës së tij, kërkon qasje shumë dimensionale. Veprimtaria e tij bëri që t'i atribuohen shumë epitete si njeriu më i ditur i kohës, filozof i kishës, doktor i kishës, bibliograf, përkthyes i përsosur, letrat dhe si njëri që kontribuoj në përhapjen e civilizimit evropian.

Origjina dhe koha e Shën Jeronimit

Shën Jeronimi (Hieronymus) së bashku me Niketë Dardanin nga Remesiana dhe disa emra të tjerë të historisë e të kulturës antike dhe të hershme mesjetare, bëjnë pjesë në korpusin e dijetarëve të mëdhenj të Kishës dhe të civilizimit perëndimor.

Shën Jeronimi u bë i njohur në histori me emrin Shën Jeronimi apo Eusebius Hieronymus, si e ndeshim në dokumente të kohës, ndërkaq Sophronius ishte pseudonimi. U lind në Stridon të Dalmacisë. Megjithatë, sipas biografëve të tij, rreth çështjes së vendlindjes dhe vitit të lindjes ka pasur dhe ka mendime të ndryshme.¹ Figura e tij madhështore ka luhatur

¹ Mbi pikëpamjet e ndryshme mbi vendlindjen e Jeronimit, në mënyrë të veçantë krahaso: O. I. Marković, Izabrane poslanice sv. Jeronime, Zagreb 1908 (në vijim: Izabrane poslanice sv. Jeronime); W.F. Wingfield, A tour i dalmatia, Albania, and Montenegro with an historical sketch of the Republic of Ragusa (from the earliest times down to its final fall), London 1859.; Studies in Christian Biography: or hours with Theologians

ndonjë studiues aq tepër sa që ia ka ndërruar fare edhe vendlindjen e tij. Kështu, sikurse shumë qytete greke të antikitetit më të hershëm që bënin përpjekje të përvetësonin vendlindjen e Homerit, ashtu ndodhi edhe me vendlindjen e Jeronimit. P.sh. Flavio Biondo (1463) ka shkruar në periodikun Italia Illustrata, se Jeronimi ka lindur në Istri, e cila në atë kohë i takonte Italisë.²

Megjithatë, sot është e pranuar se Shën Jeronimit është me origjinë ilire nga Stridoni i Dalmacisë, për të cilën ka deklaruar disa herë edhe vetë duke thënë: Miserere mei Domine, quia Dalmata sum (Më fal, o Zot, se jam dalmat). Kurse, në një rast tjetër, për vendin ku ka lindur, Jeronimi thotë: “Jeronimi meshtar, i lindur në Stridon, i shkatërruar nga Gotët, dikur ishte kufiri i Dalmacisë dhe Panonisë[...]”.³ Ndërsa Thomas Archidiaconus shkruan kështu: “Tash Dalmacia është një vend bregdetar që fillon nga Epiri ku gjendet Durrësi dhe shtrihet deri te Kvarneri dhe aty gjendet qyteti Stridon, i cili dikur ishte kufi midis Dalmacisë dhe Panonisë”⁴

Për ta përforcuar mendimin mbi origjinën ilire të tij, po përmendim edhe një veprim në lidhje me postin e Papës. Duke çmuar aftësitë dhe meritat e tij, Jeronimit ia kanë ofruar postin e papës. Mirëpo, ai e refuzon këtë post më të lartë kishtar me arsyetim se si dalmat që ishte, ka natyrë të vrullshme, është gjaknxehtë dhe si i tillë nuk është i përshtatshëm për postin më të lartë në hierarkinë kishtarë,⁵ gjë që tregon origjinën e tij dhe moralin karakteristik shqiptar në lashtësi.

Kurse sa i përket vitit të lindjes, janë dhënë mendime të ndryshme duke filluar nga viti 331 e deri në vitin 347. Megjithatë, së fundi dominon mendimi se ka lindur në vitin 345.⁶ Të dhënat për familjen e Jeronimit janë të pakta. Dihet vetëm se e kishte një motër dhe një vëlla më të vogël me emrin Paulin (Paulinianin), i cili kishte jetuar në Betlehem.⁷ Jeronimi, mësimet e para i filloi në vendlindje, kurse pas moshës 18 vjeçare shkoi në Romë dhe pranohet në shkollën e filologut të njohur romak Elius Donatit. Atje studioi gramatikën, retorikën dhe filozofinë, mësimet e cilat do të ndikojnë në veprimtarinë e tij për t’u bërë ati (pifti) më i ditur i Kishës

and Reformers. by Samuel Osgood. New York & Boston 1850: F.Z. Collombet. Histoire de Saint Jérôme père de l’Eglise au IV siècle. tome I-II. Lyon 1844: Ph. Schaff. H. Wace. A Select Library of Nicene and Post-Nicene Fathers of the Christian Church: St. Jerome: Letters and select works. New York 1893. passim. 2 O. I. Marković. Izabrane poslanice sv. Jeronime. 4-5.

3 “*Hieronymus prosbyter. natus Stridone. quod a Gothis eversum Dalmatiae quondam et Pannoniae confinium fuit*” (De Vir. ill. c.135. Opp. II, 755). Cituar nga O. I. Marković. Izabrane poslanice sv. Jeronime. 8-9.

4 “*Nunc Dalmatia est regio maritima. icipiens ab Epyro. ubi est Dirachium. et protenditur usque ad sinus Quarnarium. in cuius interioribus est opium Stridonis. quod Dalmatie. Pannonieque confinium fuit*”. Thomas Archidiaconus. Zagreb. 1894. 3.

5 M. Krasniqi. Besa në traditën shqiptare. ASHAK Prishtinë 2011. 86-87.

6 Der Kleine Pauly. Lexikon der Antike. Band 2. München 1979. 1137-1138. Vitin 345. si vit të lindjes së Shën Jeronimit. së fundi e ka përkrahur edhe studiuesi E. Sedaj në studimin tij: Bibla & përkthimet në gjuhën shqipe. Prishtinë 1999. 107. (në vijim: Bibla & përkthimet)

7 O. I. Marković. Izabrane poslanice sv. Jeronime. 39.

Romane. Ai ishte një studiues serioz, i pasionuar në letërsinë latine; si i tillë i vizitonte shpesh katakombet në Romë dhe kah fundi i arsimimit të tij romak u pagëzua (rreth vitit 366), ndoshta nga Papa Liberius.

Pas pagëzimit tërhiqet në selinë mbretërore Trier, ku vendosi të bëhej asket, që ishte një vlerë e madhe edukative në rrugën e shenjtërisë.

Në Aquileia (Itali), ai krijoi lidhje me elitën asketike të mbledhur rreth peshkopit Valerianus, në të cilin grup bënte pjesë edhe Rufinusi, shkrimtar dhe studiues, i cili kishte përkthyer teologun aleksandrian të shekullit të III-të, Origenin. Pas shpërbërjes së këtij grupi (rreth vitit 373) për arsye të panjohura deri me tani, Jeronimi vendosi të bënte një udhëtim shtegtimi në Jerusalem për të vizituar Tokën e Shenjtë. Në rrugë për në Palestinë, ai vizitoi Antiokinë (374), ku u prit miqësisht nga prifti Evagrius, vend në të cilin ishte sëmur rënd për shkak të ndryshimit të klimës dhe mënyrës së jetesës. Pas shërimit, në vitin 375, Jeronimi i'u qas një kërkimi dy vjeçar të paqes së brendshme si eremit (vetmuar) në shkretëtirën Kalikis të Sirisë, për të mësuar hebraishten, kurse greqishten do ta përsosë gjatë qëndrimit në Konstantinopojë. Sa i përket hebraishtes thuhet se e mësoi nga një vendas, pas së cilës arriti të kopjoi dorëshkrime për bibliotekën dhe shokët i tij si dhe mbante korrespondencë në këtë gjuhë.

Udhëton edhe në vende të tjera të Perandorisë, siç ishin: Galia, Egjipti, Greqia, etj. Duke parë këtë përgatitje intelektuale të tij, të pajisur me bindje asketike dhe me modesti shenjtërore, ipeshkvi i Antiokisë, Paulini, e shuguron prift në vitin 379, kurse dy vjet më vonë, e cakton këshilltar të vetin në Koncilin e Konstantinopojës (381).⁸

Kështu pas një aktiviteti të dendur dhe të një përgatitje shpirtërore në vendet e shenjta, në vitin 382 Jeronimi emërohet në Romë sekretar i papës Damasit (366-385), i cili do t'ia besojë rileximin e teksteve biblike. Në Romë qëndroi vetëm tri vite, dhe pas vdekjes së papa Damasit (385), përsëri kthehet në vendet e Lindjes, në Antioki dhe Aleksandri. Nga Antiokia, në vjeshtën e vitit 386 do të vendoset në Betlehem, ku do të themelojë tri manastire të grave dhe një të burrave. Në manastirin e burrave do të veprojë edhe shkolla biblike, në të cilën ai do të kryej punën më të madhe rreth rishqyrtimit të teksteve biblike, përkatësisht të përkthimit të Biblës integrale nga gjuhët burimore në gjuhën latine. Në Betlehem kaloi një jetë të përsëritshme deri sa ndiq më 30 shtator 420?⁹

Kisha e Romës e çmonte lartë Jeronimin dhe kujtimet e tij, siç thuhet në sakramentarin e Gregorit të Madh, kurse në kalendarin katolik emri i tij përkujtohet më 30 shtator.¹⁰ Në Martyrologium Romanum, Shën Jeronimi përmendet me këto fjalë: “Në Betlehem u varros Shën Jeronimi i

8 Ibid., 39-53.

9 Der Kleine Pauly. Lexikon der Antike, 1140.; O.I. Marković, Izabrane poslanice sv. Jeronime, 57.

10 Kalendar Katolik për vitin 2006, Kuvendi Françeskan, Gjakovë 2006.

besueshmi dijetari i Kishës, i cili i njihte të gjitha shkencat shoqërore dhe kështu u bë prifti më i ditur, i cili dijën e vet ia nguliti edhe tjerëve[...]. Kurse në një periudhë të gjatë të mesjetës, bashkë me Shën Augustinin, Shën Ambrozin dhe Shën Gregorin e Madhë, Shën Jeronimi do të quhet "egregius doktor ecclesiae" (Mësues i shkëlqyeshëm i Kishës apo Doktor i Kishës Romane). Më vonë trupi i tij u bart në Romë dhe u riarros në bazilikën e Shën Mërisë.¹¹

Në Dalmaci, dita e Shën Jeronimi nderohet më një respekt të veçantë. Ky nderim është fuqizuar edhe me ligj. Kështu, në Ligjin dhe Statutin e Trogirit (Dalmaci) të vitit 1455 është futur plotësimi për respektimin dhe krentrimin e Ditës së Madhe të Shën Jeronimit "ashtu që asnjëri dhe asnjë person në qytet, në kopshte dhe në rrethin e Trogirit atë ditë nuk guxon të punojë as të bëjë diçka, i cilësdo klasë, rend apo pozitë që të jetë, por duhet të heqë dore fare prej çfarëdo pune ditën e krenntes së Shën Jeronimit", e "sidomos u ka hije të nderojnë më së shumti dalmatinasit, sepse në Dalmaci është i lindur"¹²

Veprimtaria letrare dhe shkencore

Shën Jeronimit i atribuohen një korpus i madh veprash, kurse vlera e këtyre veprave ka qenë objekt i shumë studiuesve dhe polemikave gjatë shekujve.

Vepra që u tërhoqi më tepër vëmendjen mban titullin Epistulae (Letrat), e cila përveç vlerave të mëdha teologjike, historike e filozofike, zotëronte edhe vlera të mëdha artistike dhe burimore të një zhanri të ri letrar në letërsinë evropiane.

Në mesin e 147 letrave që përbëjnë Epistolarin e tij, 26 i janë drejtuar Jeronimit, prej tyre 10 Shën Augustinit. Tërë personaliteti i Jeronimi është i gërshetuar në këto letra: fantazia e zjarrtë dhe karakteri impulsiv, stili i njohur dhe polemik i rreptë, që nuk fshehë dashurinë ndaj shkrimtarëve paganë romak, mirëpo as idealet e veta askete të drejtuara kah e mira e kishës.¹³ Rëndësia e këtyre letrave rritet edhe nga fakti së në to gjejmë përshkrime edhe për ilirët dhe Ilirinë si dhe për vendlindjen e tij, Stridonin.¹⁴

Për historiografinë letrare në ngushtë është me rëndësi të posaçme vepra De viris illustribus liber (Libër mbi njerëzit e shquar), i njohur edhe me titullin De scriptoribus ecclesiasticis (Mbi shkrimtarët kishtarë), e botuar në vitin 392, e që është njëherit edhe historia e parë e

11 O.I. Marković, Izabrane poslanice sv. Jeronime, 59.

12 A. Mutnjaković, Andreas Alexius Epirota, Rilindja, Prishtinë 1981, 120. (në vijim: Andreas Alexius Epirota)

13 Historia e Letërsisë Botërore, lib.2, Rilindja, Prishtinë, 1985, 304.

14 Më gjerësisht shih, po në këtë punim në titullin: Ilirët dhe Iliria te Shën Jeronimi.

letërsisë kristiane prej Shën Pjetrit apostul, e deri në ditët e tij.¹⁵ Kjo vepër, e cila është një katalog, ku ka prezantuar biografitë e 135 shkrimtarëve kristian (135 kapituj), është plotësim i veprës së humbur të Euzebit të Cezaresë, por në tërësi e shkruar sipas modeleve të klasikëve, sidomos duke pasur parasysh veprën e Seutonit. Qëllimi i autorit ishte që të dëshmonte para botës se edhe shkrimtarët kristian nuk mbesin prapa klasikëve paganë. Ndërkaq në jetëshkrimin e shenjtoreve (Vita Pauli, Vita Malchi, Vita Hilarionis), kemi një dimension të ri përmbajtjesor në historinë e letërsisë botërore.¹⁶ Gjithashtu, edhe në këtë vepër Jeronimi ofron shënime edhe për vetveten ku ndër tjera thotë: “[...]Junë, Hieronymi, biri i Eusebit, nga qyteti Stridon[...]”.¹⁷

Një vepër tjetër e cila sot është burim i shënimeve, kurse në mesjetë ishte themel i kronografisë së përgjithshme është *Chronica* (Kronika), e cila në të vërtetë është plotësim i përkthimit nga greqishtja i veprës së Euzebit të Cezaresë, e cila paraqet historiografinë para Aleksandërit të Madh.¹⁸ Kurse me përmbajtje kishtare shkroi edhe trajtesat: *De spiritu sancto* (Mbi shpirtin e shenjt), *De situ et nominibus locorum Hebraicorum* (Mbi shtrirjen dhe emrat e vendeve hebraike), *De nominibus Hebraicis* (Mbi emrat hebraikë), *Questiones hebraicae in genesim* (Çështje hebraike në burimësi), si dhe polemikat e ashpërta, *Adversus Jovinianum* (Kundër Gjonit), *Contar Vigilantium* (Kundër Vigilanit), *Adversus Helvidium* (Kundër Helvidit), *Apologia adversus Rafinum* (Apologjia kundër Rufinit), *Commentariorum in Sophoniam prophetam liber* (Libër komentaresh për profetin Sofon), etj.¹⁹

Në korpusin e veprave të tij bëjnë pjesë gjithsesi edhe përkthimet e homilive të filozofit të njohur alaksandrin Origjenit, sikurse edhe shumë shënime nga përvoja e tij e pasur përkthyesë nga gjuha hebraike dhe greke.²⁰

Vulgata dhe interpretimet e saja

Megjithatë, veprimtarinë e madhe letrare dhe shkencore që e theksuam më lartë, emri i Shën Jeronimit më së shumti identifikohet si përkthyes i Bibles, nga gjuha hebraike në gjuhën latine, e cila do të quhet *Vulgata*. Mirëpo para se të flasim për përkthimin e Biblës nga Jeronimit, që te kemi

15 Cfr.: M. Marulić, *Starozavjetne ličnosti – De veteris instrumenti viris illutribus commentarium*, SNL, Zagreb 1984, 15-18. Autori i këti libri, Mark Maruli, i bënë një përshkrim dhe komentim të hollësishtëm kësaj vepre të Jeronimit.

16 M. Budimir-M. Flašar, *Pregled rimske književnosti (de auctoribus romanis)*, Beograd 1963, 633.; *Historia e Letërsisë Botërore*, lib.2, 304.

17 Ilirët dhe Iliria te autorët antik, 354.

18 M. Budimir-M. Flašar, *Pregled rimske književnosti*, 633.

19 Der Kleine Pauly. *Lexikon der Antike*, Band 2, 1138-1140.

20 E. Sedaj, *Bibla & përkthimet*, 112.

një pasqyre të qartë mbi shkaqet që shtynë Jeronimin që t'i hyjë kësaj beteje të madhe, së pari duhet të njihemi se në çfarë gjendje ishte Bibla para këtij përkthimi ?.

Nga të dhënat historike na është e njohur se pas pushtimit të Jerusalemit nga romakët (viti 70) dhe pas shkatërrimit të tempullit çifutë në Jude, një pjesë e çifutëve të ikur (diasporës) u vendosën në qytetin e Aleksandrisë. Thuhet se çifutët e Aleksandrisë u helenizuan shumë më tepër se ata të Judesë, dhe e harruan hebraishten. Për këtë arsye u pa e nevojshme të përkthehej Dhiata e Vjetër në greqisht: rezultati ishte Septuaginti. Kurse Pentateuku ishte përkthyer në mes të shekullit të tretë para Krishtit, pjesët e tjera disi më vonë. Për ta përkthyer Dhiatën e Vjetër në greqisht, kryepriifti i çifutëve Elaezari, caktoi nga gjashtë vetë prej çdo fisi hebraik. Mbasi ishin 12 fise hebraike, u zgjodhën 72 veta dhe puna u krye brenda 72 ditëve. Mu për këtë edhe ky përkthim u quajt Bibla e hebrenjve në diasporë, përkatësisht në shkencën biblike quhet SEPTUAGINTA. Kur versionet e tyre u krahasuan u gjet se ishin identike deri në detajet më të vegjël. Megjithatë, studimet më të vonshme treguan se Septuaginti kishte defekte të mëdha.

Të krishterët e fillimit, duke mos ditur hebraishten, u bazuan tek Septuaginti, apo tek disa përkthime të tij në latinisht. Një tekst më i mirë, ndonëse me disa gabime, doli nga puna e Origjenit në shekullin e tretë.²¹

Siç e theksuam edhe më parë, papa Damasi ia kishte besuar Jeronimit rishqyrtimin e teksteve biblike, ngase me përkthimet e mëparshme në gjuhën latine, të njohura si Vetus latina (Përkthim i vjetër latin), nuk ishin të kënaqur në Perëndim për shkak të mangësive dhe gabimeve të shumta gramatikore dhe ortografike. Pas vdekjes së papës Damasit, Jeronimi tërhoqet prapë në Betlehem, ku serisht iu përvesh studimeve hebraike, me qëllim që të shqyrtonte përkthimin grek të Besëlidhjes së Vjetër (Septuaginta). Kështu fillon edhe përkthimin integral të Biblës nga origjinali hebraisht duke e krahasuar me greqishten në gjuhën latine.²²

Jeronimi kishte informacion të plotë për gjendjen e teksteve burimore dhe të përkthimeve të këtyre teksteve në gjuhët e lindjes, në gjuhën greke dhe në gjuhën latine. Siç dihet përveç Septuagintës, ekzistonin përkthime të tjera greqisht, targume të shumta, që ishin përkthime karakteristike ose shpjegime armenisht, pastaj përkthime kopisht (në disa dialekte), siriakisht, etj. Ç'është e vërtetë, renditja e punës së tij kishte filluar nga Besëlidhja e Re për të kaluar në Psaltir (Psalterium Romanum) dhe në libra të tjerë të Besëlidhjes së Vjetër, gjithëherë duke qenë në konsultim me rabinët

21 Cfr.: B. Russell, Një histori e filozofisë perëndimore (Filozofia katolike) lib.II. Tiranë 2004, 30-31.: Për Biblen para dhe pas përkthimit nga Shën Jeronimi shih më gjerësisht edhe te: Wilfrid J. Harrington, Uvod u Bibliju, spomen objeva, SK, Zagreb 1977, veçanërisht prej fq. 147-152.

22 Ibid., 86.

e shkolluar, sidomos me mikun e tij, rabinin Baranin. Studiuesit kanë konstatuar se ai kishte respekt të shtuar ndaj teksteve hebraike, përkatësisht ndaj të vërtetës hebraike dhe kanonit hebraik. Gjatë përkthimit, Jeronimi ka zbatuar gjithësi mënyrën shkencore në çdo pikëpamje, sikur në kuptimin e drejt të tekstit burimor, ashtu edhe në bartjen e tij në gjuhën latine, duke respektuar të gjitha karakteristikat gjuhësore të kësaj gjuhe dhe duke u mbështetur në veçori morfo-sintaksore dhe leksikore që janë të natyrës, si të thuash, popullore (lat.vulgus-popull).

Kjo, bëri që përkthimi, përkatësisht rishqyrtimi i Biblës integrale në shek.V të merr përmasa të gjëra, që më në fund, në shek.VI të pranohet nga të gjitha kishat. Në kohën e Karlit të Madh, në vitin 800, mendohet se ishte versioni i vetëm që përdorej gjithkund edhe në liturgji, kurse në kohën e Gutembergut, Bibla e Jeronimit qe libri i parë që u botua në shtypshkronjën në vitin 1452, nga i cili botim sot janë ruajtur nja 45 kopje.

Më vonë, pikërisht me 8 prill 1546, në Koncilin e Tridentit, u zyrtarizua për përdorim përkthimi i Jeronimit si “autentik” me fuqinë disiplinore, duke e quajtur Vulgata, me dekret vetëm për Kishën Katolike të Romës, pra për atë pjesë të Kishës, ku mund të hynte në përdorim gjuha latine. Më 1592 është bërë edhe një redaktim i Vulgatës, sipas urdhrin të papës Klementit VIII, kështu që deri vonë ishte në përdorim e ashtuquajtura Vulgata Clementiana, kurse më 25 prill 1979, të nënshkruar e të lejuar nga papa Gjon Pali II, botohet Nova Vulgata (Bibliorum sacrorum editio typica prior a MCMXXIX, pp.2326) e shën Jeronimit, në të cilën Vulgatë është mbështetur edhe përkthyesi i Biblës integrale në gjuhën shqipe dom Simon Filipaj.²³

Në Vulgatën e tij, Jeronimi nuk dallohet vetëm si filolog i ditur, i cili përkthen me zotësi nga origjinali, hebraisht duke krahasuar me greqisht, por aty ai na del edhe si artist i talentuar i fjalës, si krijues gjenial, që ka ditur të deportojë në thellësinë e mendimit të përsosur të tij. Në të, si dhe në Epistolet, gjuha e Jeronimit është më e zgjedhura dhe më e përsosura. Jeronimi e krijoi normën për shekujt e më vonshëm të shprehjes latine kristiane dhe ka ndikuar në mënyrë direkte edhe në gjuhët letrare popullore. Në shumë vende në veprat e tij edhe teorikisht i ka arsytuar përvojat e veta në përkthim.²⁴

Në mesjetë, por edhe më vonë Jeronimi me të drejtë është konsideruar si njëri nga përfaqësuesit më të mëdhenj të humanizmit kishtar.²⁵ Tek ai njerëzit e Renesancës kishin gjetur modelin e stilit, kishin pëlqyer temperamentin e tij luftarak. Ky humanist e filolog i shquar thajse i pashoq, me veprën e vet, siç ka pohuar edhe studiuesi Aleksandër Stçiçeviq,

23 E. Sedaj, Bibla & përkthimet, 108-110.

24 Historia e Letërsisë Botërore II, 304.

25 Ibid., 305.

e shkruar rreth vitit 395. Në këtë letër jep udhëzime se si duhet të lexohet Shkrimi i Shenjtë ose Besëlidhja nga një anë dhe, nga ana tjetër flet me dobi të argumentit të lashtësisë – prioritetit të vetë Biblës ndaj të menduarit shkencor pagan. Aty theksohet në dobi të argumentit të lashtësisë – prioritetit të vetë Biblës ndaj të menduarit shkencor pagan. Kështu, prandaj kur flet për Librin e Numrave, thekson se aty paraqiten të gjitha fshehtësitë e matematikës. Kur fletë për Librin e Jobit, thekson se në të gjenden të gjitha rregullat e didaktikës në aplikim. Po aty Jeronimi e ka krahasuar Davidin me Simonidin, Pindarin, Alkeun, Horacin, Katulin dhe Serenin. Në letrën në fjalë që shpreh njëkohësisht edhe njohjen e shkëlqyeshme të filozofisë dhe të literaturës klasike, Jeronimi shprehimisht thotë se as Pjetri as Gjoni nuk kanë qenë peshkatarë të paarsimuar.³²

Nga kjo shihet qartë se për Shën Jeronimin kuptimi i Biblës nuk është i mundur pa njohjen e filozofisë dhe literaturës klasike. Këtë qëndrim e shpreh qartas në parathënien e Kronikës botërore të Euzebit të Cezaresë, që e përpunoi në sistemin tabelar, të përshkruar me shënime historiko-letrare dhe u bë gurëthemel i “kronikës së letërsisë historike” në të cilën do të përqendrohet pastaj Izidori i Sevilës.³³

Për qëndrimet e Jeronimit ndaj letërsisë klasike dhe korrespondencës së trajtave letrare të teksteve biblike me ato të teksteve shekullare, flasin edhe autorët e mëvonshëm. Jeronimi, në të vërtetë, këtë konkordancë të letërsisë pagane me atë të teksteve biblike e shpreh edhe në parathënien që i paraprinë Vulgatës, përkthimit të tij.³⁴

Ilirët dhe Iliria te Shën Jeronimi

Për sa i përket të dhënave që na jep Jeronimi mbi ilirët dhe Ilirinë, ato janë natyrave të ndryshme. Në to flitet për sulmet e gotëve dhe barbarëve të tjerë në fundin e shek.IV, për shkatërrimet e plaçkitjet që pësojnë krahinat e ndryshme të Ballkanit, për përhapjen e krishterimit në këto hapësira; ai jep gjithashtu dhe njoftime të tjera me karakter gjeografik e administrativ.

Në të gjitha veprat e tij, madje edhe në letrat ka të dhëna edhe për “vendin tim, ku kam lindur”, shkruan Jeronimi. Ai në shkrimet e veta përmend fakte të rralla, por shumë të rëndësishme për popullin e tij. Kështu në lidhje me gjuhën ilire thotë: “[...]se ilirët deri në Perandorinë e vonshme (romake) fitnin ekskluzivisht në gjuhën e tyre...”. Po ashtu me pietet flet për birrën ilire të quajtur sabaum ose sabaia që e përdornin

32 Studies in Christian Biography, 136; I. Ahmeti, Letërsia kishtarë dhe filozofia e saj, Prishtinë 2000, 88.

33 Mbi qëndrimin e Jeronimit ndaj kulturës autorëve antikë, krahaso: K. N. Macfarlane, Isidore of Seville and the pagan gods (Origines VIII.11), Philadelphia 1980, 3-9.; E.R. Curtius, Evropska knjizevnost i latinsko srednjovekovlje, Zagreb 1971, 454.

34 E. R. Curtius, Evropska knjizevnost, 78.

bashkë me një pije prej mjalti. Ndërsa në mitologji dhe në antropologji, legjenda e Shën Jeronimit e shënuar mbi jetën e Shën Hilarionit, i cili e mbytë gjarprin Boas dhe i shpëton banorët e Epidaurit, është komentuar edhe nga pikëpamja shkencore nga Artur J. Evans, më vonë si personifikim i fitores së krishterimit ndaj besimit pagan, si lidhje e mitologjisë vendase me religjionin e ri.³⁵

Sipas studiuesit Z. Mirdita, i cili është marrë me studimin e zhvillimit të historiografisë kishtarë, rrënjët e historiografisë kishtarë shqiptare janë shumë të lashta dhe ato lidhen me veprën e Shën Jeronimit “Mbi njerëzit e shquar”.³⁶ Në të vërtetë Shën Jeronimi e rikonfirmon pohimin e Shën Palit dhe ofron dëshmi në lidhje me përhapjen e krishterimit në Iliri në krye me këtë apostull, duke thënë: “In omnibus locis versabatur[...]cum Paulo in Illyrico” (U përhap në të gjitha vendet [...] me Palin në Ilirik).³⁷

Kurse në lidhje me dyndjet e popujve barbarë dhe shkatërrimet që përjetuan territoret ilire, Shën Jeronimi dëshmitar i këtyre ngjarjeve të tmerrshme, i përshkroi në Epistolae me fjalët: “më rrëqethet shtati kur mendoi të tregoi për shkatërrimet në kohën tonë. Në vazhdim të njëzet vjetëve, bile edhe më tepër, gjaku romak derdhet për çdo ditë ndërmjet Konstantinopolit dhe alpeve Jule: goti, sarmatë, kuadi, alani, huni, vandalët dhe markomanët shkretojnë, plaçkitin dhe grabisin Skythinë, Thrakinë, Maqedoninë, Dardaninë, Dakinë, Thesalinë, Ahenë, Epirin, Dalmatinë dhe gjithë Panoninë. Sa matrone*, sa virgjëresha kushtuar Zotit, sa njerëz të lirë dhe fisnikë u dhunuan në këto lufta! U morën robër peshkopë, u vranë presbiter dhe shërbyes të tjerë të ndryshëm të kishës. U shkatërruan kishat. Pranë altarit të Krishtit u vendosën si në grazhd, kuajt. Kockat e martirëve u nxorën nga varret. Kudo zi, kudo ofshe dhe pamje vdekje[...].³⁸ Më pas letra vazhdon në lidhje me shkatërrimet që i pësojë vendlindja e tij: “[...] për këtë arsye [...] u detyruam të dërgojmë në atdheun tonë* vëllain Paulinianin, që të shiste shtëpitë e vogla gjysmë të shkatërruara, të cilat u shpëtuan duarve të barbarëve, dhe pasurinë e prindërve tanë të përbashkët, në mënyrë që të mos t’u japim rast të qeshin smirëzesëve dhe atyre që mendojnë keq, duke lënë pa kryer punën e shenjtë që kemi ndërmarrë [...]”.³⁹

Gjithashtu në lidhje me sulmet e gotëve në veprën e tij Comentariorum in Sophoniam prophetam liber (Libër komentarësh për profetin Sofon) shkruan: “[...] kur shkatërrohen qytetet dhe vriten njerëzit, ikin dhe rrallohen edhe kafshët, zogjtë e peshqit. Për këtë është dëshmitar, Iliriku, dëshmitarë

35 A. Sipçeviq, Ilirët, 190.

36 Cfr.: Z. Mirdita, Krishterimi ndër shqiptarë. Prizren-Zagreb 1998. 69.

37 Ibid., 147.

* *Gra fisnike*

38 Epistolae XL, në: Ilirët dhe Iliria te autorët antikë. Tiranë 2002. 354.

* *Është fjala për vendlindjen e Jeronimit në qytetin Stridon të Dalmacisë.*

39 Epistolae LXXVI, në: Ilirët dhe Iliria te autorët antikë. 354.

është Thrakia, dëshmitarë është edhe vendi ku kam lindur, ku çdo gjë u zhduk përveç qiellit e tokës, gjembave që rriten dhe pyjeve të dendura”. Kurse në veprën e tij *De viris illustribus liber* (Liber mbi njerëzit e shquar), jep informata edhe për vetveten :”Unë, Hieronymi, biri i Eusebit, nga qyteti Stridon, i cili dikur gjendej në kufi në mes Dalmatisë dhe Panonisë dhe që u shkatrrua nga gotët deri në këtë vit [393] dhe pikërisht deri në të 14-in vit të sundimit të perandorit Teodos, shkrova këto vepra[...]”.⁴⁰

Shën Jeronimi në relievet e skulptorit Andrea Aleksit

Jehona e Shën Jeronimit ka qenë e madhe në shekuj të ndryshëm. Jeta dhe veprimtaria e tij u bënë frymëzim për shumë studiues të ndryshëm. Me figurën e tij u morën jo vetëm biografë e gjuhëtar por edhe piktorë e skulptorë të ndryshëm. Kështu, figurën e Shën Jeronimit e pikturon vetë Leonardo da Vinçi. Njihen më shumë se 1500 portrete të Jeronimit në pikturën evropiane.⁴¹ Disa figura re relieve të Jeronimit i ka bërë edhe skulptori i madh shqiptarë i shekullit XV Andrea Aleks Durrësaku, apo siç quhet ndryshe edhe si Andreas Alexius Epirota Durachinus (1425-1505).⁴²

Interesimi i Andrea Aleksit për figurën e dhe relievet e Shën Jeronimit është rezultat i situatës së vështirë të viteve tetëdhjetë të shekullit pesëmbëdhjetë në të cilën u gjend Dalmacia, pikërisht është fjala për kohën e rënies së Krujës në duart e turqve, kurse ekspansioni turq erdhi deri në dyert e Dalmacisë. Edhe Andreu, sikur i ka ndje disa lidhje intime me këtë njeri (Jeronimin) të madh dhe artist të madh, me këtë bashkatdhetar të humbur në shkretëtirë, me këtë shkrimtar që me nostalgji e përkujtonte vendlindjen e vet, dhe sikur andria këtë lidhshmëri të tij intime dëshironte ta muronte në gur me shumë inkarnime të figurës së Jeronimit. Sot janë të njohura njëmbëdhjetë relieve të këtilla, kurse për të tjerat supozohet se gjithashtu janë vepër e oficinës së tij.

Relievin e parë të këtillë Andreu e punoi në pagëzimoren e tij të Trogirit, kurse njëzet vjet më vonë e ndërtoi përsëri relievin Shën Jeronimit për kishëzën e asketëve të Shën Jeres në Marian (afër Splitit). Edhe sot është e ruajtur kjo shpellë askete në të cilën me shekuj kanë jetuar asketët pranë kësaj kishëze mbi altarin e të cilit Andreu e ka ndërtuar relievin e vet me përkushtim dhe emrin e vet si dhurues (Andreas lapicida) dhe me shënimin e vitit 1480 si vit i dhuratës.⁴³

40 *De viris illustribus liber*, CXXXV, në: Ilirët dhe Iliria te autorët antikë, 354-355.

41 M. Zeqo, *Motive arkeologjike dhe shkrime të tjera*, Tiranë 1990, 120.

42 Për jetën dhe veprimtarinë e skulptorit shqiptar Andrea Aleksit shih.: A. Mutnjakoviç, *Andreas Alexius Epirota*, 150; R. Sokoli, *Figura të ndritura (Jan Kukuzeli dhe Andrea Aleksit)*, Tiranë 1965, 53.

43 *Ibid.*, 115.

Përpos këtyre dy relieveve të sigurta ekziston edhe i treti për të cilin mund të thuhet me siguri se është vepër e Andreut ose e ofiçinës së tij. Relievi gjendet në Londër dhe dikur është menduar si vepër e skulptorit italian Pietro Lomnardi, kurse më vonë është vetëtuar nga Cvito Fiskoviq, se ky punim është vepër e ofiçinës së Andreut. Siguria e atribuimit të këto tri relieve bën të mundshme që Andreut t'i atribuohen edhe disa relieve të pasinjifikuara të Shën Jeronimit, që gjenden në disa vende në Dalmaci dhe në botën e jashtme. Kështu, në Galerinë e Arteve në Split është një relief i Jeronimit më i vogël (i madhësisë 39x36,5 cm.) i punuar prej gurit të Trogirit.

Në kishën e Shën Gjonit në Zarë është zbuluar relievi i Shën Jeronimit me dimensione të ngjashme (34x35 cm.) sikurse ai i mëparshmi dhe duke e krahasuar përsëri me relievin e Marianit (forma e shpellës është e ngjashme, përpunimi i murit gjithashtu, i njëjti është edhe vendosja e luanit, librit dhe gjarprit), Petriciolo konsideron se "relievin e Zarës dhe të Marjanit e ka punuar i njëjti mjeshtrë" dhe se "mbasi në relievin e matjanit është nënshkrimi i Andreut mund të supozohet me siguri se Andreu është autor i relievit të Zarës".

Në lapidarin e Dubrovnikut gjendet gjithashtu një relief i ngjashëm dimensionesh më të vogla (38x40 cm.) që më parë ka qenë muruar buzë kishës së Zonjës së Kashtelit në Dubrovnik. Për këtë, Kruno Prijateli konstaton se përkundër disa ndryshimeve ekziston "ngjashmëri e padyshimtë" në mes të relievit të Dubrovnikut dhe atij të Splitit.

Në bazë të këtij relievi Fiskoviq dhe Petriciolo me ofiçinën e Andreut e kanë lidhur relievin e Shën Jeronimit (madhësia 31x39 cm.) që gjendet i murosur nën rrasën e varrit të Gaspar Bolduit në kishën e Shën Maria de Ciglio në Venedik. Gjithashtu, në Dubrovnik gjendet edhe një relief, përsëri me madhësi të ngjashme (37x39), që rrjedh nga Sllani, i cili është i vendosur në Galerinë e Arteve. Ky relief ndryshon pak nga ata të mëparshmit për nga tretmani i shpellës, rrudhat e rrobave dhe shenja e re ikonografike në formë të kryqit.⁴⁴

Në koleksionin e Romës, gjithashtu gjendet një relief i Shën Jeronimit, kurse historianët, ia atribuojnë Andreut edhe një relief të këtillë nga koleksionet e huaja, përkatësisht në muzeun Jacquemart-Andre në Paris. Bashkë me këto relieve Petricioli, ia atribuuan Andreut ose pasardhësit të tij edhe një relief të pakryer që gjendet përmbi portalin e kishës françeskane në Kraj në ishullin Pashman, të cilin ai e konsideron kopje të relievit të Marianit.⁴⁵

44 A. Mutnjakoviq, Andreas Alexius Epirota. 117-118.

45 K. Halimi. Një artist shqiptar i Rilindjes në Dalmaci. në: Trajttime dhe studime etnologjike. IA, Prishtinë 2000, 190-191.

Në të gjitha këto relieve të përmendura të Andrea Aleksit, Shën Jeronimi është paraqitur në mënyrë besnike ikonografike si asket në shpellë me luanin, gjarprin dhe shkrabin. Ky i shenjtë është mbrojtës i Dalmacisë, prandaj edhe Lleshi e punon disa herë, qoftë sipas logjikës së porosisë, qoftë për interesimin e tij për një figurë asketi dhe për botën magjike të peizazheve të tij. Kompozicioni është shumë i bukur.⁴⁶ Portretin e Shën Jeronimit të realizuar nga Andreu e përshkruan bukur Kruno Prijatel me këto fjalë: “Shenjti rri i qetë dhe i natyrshëm, kurse lojën e bukur të vijave e krijojnë këmbët dhe shkopi në tërësinë e përbashkët të kompozuar me mjeshtëri”.⁴⁷

Shën Jeronimi është paraqitur në mase 300 punime të autorëve të ndryshëm të Evropës, është paraqitur si kardinal në shkëlqimin e purpurit, është paraqitur si intelektual në bibliotekë dhe është paraqitur si monak mistik i manastirit lindor, që në kohën e Andrea Aleksit të merrte karakteristikat ikonografike të dhëna në relievet e tij.⁴⁸ Dhe për fund, duhet theksuar se Andreu, vitet e fundit të jetës së tij ia dhuroi relieveve të Shën Jeronimit.

46 Ibid., 67.

47 Ibid., 68.

48 Ibid, 119.

Mr. Gjon BERISHA

SUMMARY

**THE CONTRIBUTION OF ILLYRIANS IN WESTERN
CIVILIZATION - CASE OF ST. JEROME**

One of the best known personalities Illyrian, Saint Jerome (c.345 – 30 September 420), (Latin: Eusebius Sophronius Hieronymus) was a Roman Christian priest, confessor, theologian and historian, who became a Doctor of the Church. He was the son of Eusebius, of the city of Stridon of Dalmatia. He is best known for his translation of the Bible into Latin (the Vulgate), and his list of writings is extensive. Jerome asserted himself Illyrian, by saying: "Miserere mei Domine, quia Dalmata sum" (Excuse me o Lord, because I am Dalmatian).

St. Jerome actually reaffirms the assertion of St. Paul and provides evidence about the spread of Christianity in Illyria at the top of this apostle, saying: "In omnibus locis versabatur[...]cum Paulo in Illyrico" (Was widespread in all countries [...] with Paul in Illyricum).

Eusebius Sophronius Hieronymus was born at Stridon around 345. He studied under the grammarian Aelius Donatus. There Jerome learned Latin and at least some Greek, though probably not the familiarity with Greek literature he would later claim to have acquired as a schoolboy.

As a student in Rome, he engaged in the superficial activities of students there, which he indulged in quite casually but suffered terrible bouts of repentance afterwards. To appease his conscience, he would visit on Sundays the sepulchers of the martyrs and the Apostles in the catacombs. Jerome initially used classical authors to describe Christian concepts such as hell that indicated both his classical education and his deep shame of their associated practices, such as pederasty. Although initially skeptical of Christianity, he was eventually converted.

Jerome translated parts of this Hebrew Gospel into Greek. He seems to have spent two years there, then left, and the next three (382–385) he was in Rome again, attached to Pope Damasus I and the leading Roman Christians.

He was given duties in Rome, and he undertook a revision of the Latin Bible, to be based on the Greek manuscripts of the New Testament. He also updated the Psalter containing the Book of Psalms then at use in Rome based on the Septuagint. Though he did not realize it yet, translating much of what became the Latin Vulgate Bible would take many years and be his most important achievement.